

REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E RRETHIT TIRANE

NR.VENDIMIT 22630

22630

V E N D I M

PER REGJISTRIMIT TE PERSONIT JURIDIK

Ne Tirane, sot me daten 17.01.2000, une gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e kerkuesve Zija Broli e Julian Broli te shoqerise ILIR shpk dhe

K O N S T A T O V A

Kerkuesit kerkojne regjistrimin ne Regjistrin Tregetar te Shoerise ILIR shpk si person juridik, me qender ne Durres, lagje nr.13, rr.B.Curri, me kapital fillestar 100.000 leke, me afat mbi 10, me ortake dhe administratore kerkuesit, me objekt te aktivitetit tregeti me shumice dhe pakice, import eksport te mallrave te ndryshem, tregetim te inerteve.

Kerkesa eshte e drejte dhe e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet te pranohet.

PER KETO ARESYE

Bazuar ne Ligjin nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite Tregetare" dhe Ligjin nr;7667 date 28.01.1993"Per Regjistrin Tregetar"


V E N D O S A :

Regjistrimin e shoqerise ILIR shpk, si person juridike, me qender ne Durres, lagje nr.13, rruga B.Curri, me kapital fillestar 100.000 leke, me kohezgjatje mbi 10 vjet, me ortake dhe administratore Zija Broli dhe Julian Broli dhe me objekt te aktivitetit tregetim me shumice dhe pakice te mallrave te ndryshme te te gjitha llojeve, tregetim te inerteve, import eksport.

Urdheroj Zyren e Regjistrin Tregetar te kryeje veprimet.

Kunder vendimit mund te behet ankim ne gjykatën e shkalles se dyte.

G J Y Q T A R E

Marjona Leolu


Urdhër regjiofshëm

1. 22630

2. a - "ILIR" shtyp,

b - selia në Durrës, d. 13, rr. "Bajram Curri".

c - objekt: Tregtim me shumicë e pakicë, import - eksport të materialeve të ndryshme.

ç - 100.000 lekë.

Zija Brolë 50.000 lekë.

Julian Brolë 50.000 lekë.

3. Administrativ:

1 - Zija Brolë : dt. 1950

2 - Julian Brolë : dt. 1979.

4. Këmbëzgjatja - 10 - jetë.

5. AKR 2 fletë

Statuti 11 fletë.

17.1.2000

Imbri

BKT Durrës, mandati qarkor nr. 0019462 dt. 17.1.2000

AKT THEMELIMI

I SHOQERISE "ILIR" ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

I hartuar nga ortaket themelues:

1. ZIJA BROLI , i biri i HALIT , dtl.10.04.1950,lindur dhe banues ne Durres ,
2. JULIAN BROLI , i biri i Zija , dtl.28.10.1979,lindur dhe banues ne Durres,

per krijimin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, e mbeshtetur ne Ligjin nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare", si vijon:

Neni 1 - Objekti i aktivitetit

Shoqeria e krijuar ka si aktivitet te saj:

- Tregetimin me shumice dhe pakice te mallrave te ndryshem, import eksport te mallrave te ndryshem ,tregetimi i inerteve.

Neni 2 - Emertimi

Shoqeria e krijuar eshte emertuar "ILIR " shpk.

Neni 3 - Qendra e shoqerise

Qendra e shoqerise eshte ne Durres, lagje nr.13, RR.B.Curri.

Neni 4 - Legjislacioni kompetent

Aktiviteti i shoqerise do te zhvillohet duke u mbeshtetur ne legjislacionin shqiptar.

Neni 5 - Kapitali shpoqeror

kapitali shoqeror fillestar eshte 100.000 leke, te ndara ne 100 kuota me nga 1000 leke secila, te cilat u takojne ortakeve si me poshte:

- Ortaku Zija Broli zoteron 50 % te kuotave e barabarte me 50.000 leke.
- Ortaku Julian Broli zoteron 50 % te kuotave e barabarte me 50.000 leke.


Neni 6 - Fitimi

Fitimi do te rezultoje nga zbritja prej te ardhurave e te gjithe detyrimeve te ligjeshme, perfshire tatimet dhe taksat e ndryshme.

Neni 7 - Kohezgjatja e shoqerise

Aktiviteti i shoqerise eshte parashikuar te jete mbi 10 vjet dhe mund te zgjatet edhe pertej ketij afati.

Shoqeria mund te priset para ketij afati me vendim te asamblese se ortakeve, ne rastet e parashikuara ne statut dhe ne ligj.



Neni 8 - Hyrja ne fuqi

Ky akt themelimi hyn ne fuqi ditën e regjistrimit te shoqerise ne organet kompetente shteterore.

Neni 9 - Zgjidhja e mosmarreveshjeve


Mosmarreveshjet qe mund te lidnin do te zgjidhen me ane bisedimesh dhe ne rast se kjo nuk arrihet, me arbitrazh ose ne rruge gjyqesore, sipas ligjit.

ORTAKET THEMELUES

ZIJA BROLI



JULIAN BROLI



REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTEREVE DURRES


NR.REP. 32 NR.KOL. 12

V E R T E T I M

Sot, me datën 17.01.2000 shtatëmbëdhjetë janar dymijë, në dhomen e NOTEREVE Durres, para meje noteres SHPRESA SKRAME, u paraqiten personalisht ZIJA BROLI i biri i Halitit, dtl.10.04.1950 lindur dhe banues në Durres, me zotesi te plote për te vepruar, identiteti sipas letërnjoftimi QH NR.477391 dhe JULIAN BROLI, i biri i Zijait, dtl. 28.10.1979, lindur dhe banues në Durres, me zotesi te plote për te vepruar, identiteti sipas pasaportes nr.1437848 leshuar në Durres me 19.8.99, te cilet para meje nënshkruan kete akt themelimi. Une noterja, bazuar në ligjin nr.7829 date 1.6.94, vertetoj.

N O T E R E

SHPRESA SKRAME



S T A T U T I

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "ILIR" SHPK

E krijuar nga keta ortake themelues:

1. ZIJA BROLI , i biri i Halil, lindur me 10.4.1950 ne Durres dhe banues ne Durres.
2. JULIAN BROLI, i biri i Zija , linduar me 28.10.1979, ne Durres dhe banues ne Durres.

me qellim qe te realizojne nje aktivitet ekonomik te perbashket te rreguar nga ky statut.

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHESHME

Neni 1

- a) Shoqeria e krijuar eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e rregulluar sipas ketij statuti e mbeshtetur ne legjislacionin shqiptar.
- b) Shoqeria eshte person juridik, personaliteti i te ciles eshte krijuar nga dita e regjistrimit te saj ne organet kompetente.

Neni 2

- a) Shoqeria eshte quajtur ILIR 'shpk.
- b) Qendra e shoqerise eshte ne Durres, lagje nr.13, RR.B.Curri.

Neni 3

- a) Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj me mjetet e veta dhe burime te ligjeshme financimi.
- b) Shoqeria do te veproje sipas legjislacionit shqiptar, sipas percaktimeve ne aktin e themelimit dhe ne kete statut.

KREU II

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Neni 4

- a) Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete :
 - Tregti me shumice dhe pakice, import eksport i mallrave te ndryshem te te gjitha llojeve.
 - Tregti me shumice dhe pakice i materialeve inerte.



b) Ne kete aktivitet shoqeria do te veproje duke kryer edhe investimet e duhura ne rast nevoje.

c) Ne te ardhmen objekti i aktivitetit mund te shtohet edhe me aktivite te tjera te lejuara nga ligji.

KREU III

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Neni 5

- a) Shoqeria do te filloje aktivitetin e saj me marrjen e licences perkatese dhe regjistrimin ne organet perkatese.
- b) Ne rast se 6 muaj nga data e regjistrimit, shoqeria nuk ka filluar aktivitetin e saj, çdo ortak ka te drejte te terheqe pjesen e derdhur prej tij ne kapitalin fillestar.

Neni 6


- a) Kohezgjatja e shoqerise eshte parashikuar mbi 10 vjet.
- b) Ne rast se 6 muaj perpara perfundimit te ketij afati, nga asnjeri prej ortakeve nuk kerkohet likuidimi i shoqerise, kjo kohezgjatje konsiderohet automatikisht si e zgjatur edhe 5 vjet te tjera dhe keshtu çdo pesevjeçar pa kufizim.

KREU IV

KAPITALI THEMELOR

Neni 7

- a) Kapitali shoqeror ne momentin e themeilit eshte 100.000 leke, te ndara ne 100 kuota me nga 1000 leke secila.
- b) Kuotat i perkasin ortakeve si me poshte:
- Ortaku Zija BROLI ka 50 kuota te barabarta me 50.000 leke
 - Ortaku Julian BROLI ka 50 kuota te barabarta me 50.000 leke
- c) Kapitali shoqeror mund te zmadhohet ose te zvogelohet sipas interesave te shoqerise, por ai nukmund te zbrese nen kufirin minimal te percaktuar nga ligji.
- d) Percaktimi i kuotave te kapitalit ne monedhe shqiptare e te huaj, do te behet sipas kursit te kembimit ne kohën e lindjes se nevojës për këtë kembim.



- e) Kapitali shoqeror mund te jete ne para ose ne vlera materiale. Vleresimi i kontributeve ne natyre behet me unanimitetin e ortakeve ose ne rast te kundert nga nje ekspert i emeruar sipas ligjit.
- f) Kuotat e kapitalit nuk perfaqesojne kotribute ne sherbime.
- g) Kuotat e kapitalit nuk perfaqesohen ne letra me vlere.

Neni 8

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet ne menytrat e meposhteme:

- a) me sjelljen direkt nga ortaket proporsionalisht me kuotat e tyre te kapitalit.
- b) me perdorimin e fitimeve te pashperndara me pare dhe/ose me perdorimin e fondeve rezerve.
- c) me menyra te tjera te lejuara nga ligji.

Neni 9

- a) Ne asamblene e ortakeve, secili ortak ka te drejte vote perpjestimisht me shume qe zoteron ne kapitamon shoqeror dhe çdo ortak ka nje vote per çdo 1000 lek.
- b) Ne rast te likuidimit te shoqerise, mbetja qe mund te rezultoje i ndahet ortakeve proporcionalisht me kuotat e kapitalit.

Neni 10

Ne rast te heqjes dore nga kuotat prej ndonjerit nga ortaket, ortaku tjetër ka te drejten e parablerjes.

Neni 11

Transferimi i kuotave perkatese, pjeserisht ose teresisht behet:

- a) Lirisht ndermjet ortakeve.
- b) me trashegimi, ndermjet bashkeshorteve e te paslindurve dhe paralindurve. Asambleja e ortakeve mund te vendose kushtet e transferimit, te cilat nuk mund te jene me pak te favoreshme sesa ato per te tretet.
- c) personave te trete, me aprovimin e nje shumice prej 3/4 e kuotave te kapitalit.

KREU V

TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKEVE

Neni 12

Ortaku ka te drejte:

- a) te marre pjese ne aktivitetin e shoqerise.
- b) te perfitoje nga fitimi i realizuar proporcionalisht me kuotat qe zoteron ne kapitalin shoqeror.



- c) te informohet dhe konsultohet me librat e shoqerise.
- d) te kerkoje nga gjykata anullimin e vendimeve te marra nga asambleja, te cilat vijne ne kundertshtim me ligjin ose me statutin.
- e) te perfitoje nga kuota e kapitalit dhe nga fitimi deri ne ditën e largimit te tij nga shoqeria ose te likuidimit te shoqerise.

Neni 14

Ortakut ka per detyre:

- a) te derdhe kuoten e tij ne kapitalin shoqeror.
- b) te njohe dhe zbatoje dispozitat e ketij statuti.
- c) te marre pjese ne administrimin e aktivitetit te shoqerise.
- d) te veproje per arritjen e qellimit te shoqerise.
- e) te mbikeqyre zbatimin e vendimeve te marra nga asambleja e ortakeve.
- f) te marre pjese, ne proporcion me kuoten e tij te kapitalit, ne perballimin e humbjeve.

Neni 14

1. Pjesemarrja ne shoqeri pushon ne rast te:

- a) vdekjes se ortakut
- b) paaftesise per shkak semundje mendore.
- c) likuidimit vullnetar te shoqerise.
- d) largimit vullnetar nga shoqeria.
- e) falimentimit te shoqerise.
- f) ne raste te tjera te percaktuara nga ligji.

2. Vlera e kuotes dhe fitimi i ortakut ne rastet e parashikuara nga germet "a", "b" dhe "d" te pikes 1 te ketij neni, percaktohet ne baze te rezultatit kontabel ne fund te muajit ne te cilin ka ndodhur ngjarja.

Neni 15

- a) Aprovimi i pranimit te ortakeve te rinj ne shoqeri, percaktohet nga asambleja, pas shqyrtimit te kerkeses perkatese me shkrim, ne te cilen, pervec te tjerave pranohen normat e ketij statuti.
- b) Largimi i ortakut behet pas shqyrtimit te kerkeses perkatese me shkrim. Ne kete rast shoqeria duhet te llogarise kuoten e kapitalit dhe fitimit qe duhet t'i likuidoje ortakut qe largohet.

- c) Largimi i nje ortaku, nuk e perjashton ate nga detyrimet e kerkueshme deri ne daten e largimit nga shoqeria.

Neni 16

Pasuria e shoqerise eshte ne pronesi te ortakeve proporcionalisht me kuotat e tyre ne kapitalon shoqeror.

Neni 17

Kuotat mund te transferohen me rruge trashegimie, duke zbatuar dispozitat ligjore ne fuqi dite e transferimit.

KREU VI

ORGANET E SHOQERISE


Neni 18

Organet e shoqerise jane :

- a) Asambleja e ortakeve
- b) Administratoret
- c) ekspertet revizore

Neni 19

- a) Asambleja e ortakeve eshte formuar nga te gjithë ortaket e shoqerise dhe eshte organ vendimor, organi me i larte i shoqerise.
- b) Asambleja e ortakeve merr ne shqyrtim dhe vendos per te gjitha problemet e shoqerise dhe ka kompetenca ekskluzive si :
 - a1. vendos per ndryshimet ne statut.
 - a2. miraton hyrjen ne shoqeri te ortakeve te rinj.
 - a3. shqyrton te drejten e parablerjes ne rast transferimi te kuotave.
 - a4. miraton bilancin vjetor dhe vendos per rezultatin.
 - a5. vendos per shtimin dhe pakesimin e kapitalit.
 - a6. vendos per likuidimin e shoqerise.
 - a7. vendos per hapjen e filialeve te reja dhe mbylljen e atyre ekzistuese.
 - a8. zgjedh administratorin dhe ekspertet.
 - a9. vendos per pjesemarrjen ne shoqeri te tjera.
 - a10. vendos per shitjen dhe blerjen e pasurive te palujtshme te shoqerise.
 - a11. vendos per organizimin e brendeshem te shoqerise.
 - a12. vendos lidhur me pershtatshmerine e investimeve me zhvillimin strukturor te shoqerise.



Neni 20

- a) Asambleja vendos me shumice votash, te cilat perfaqesojne shumicen e kapitalit te shoqerise, me perjashtim te rasteve kur ligji kerkon nje shumice te kualifikuar.
- b) Eshte e detyrueshme shumica e kualifikuar prej 3/4 te kapitalit shoqeror ne keto raste:
- transferimi i kuotave te treteve
 - ndryshimet ne statut
 - pakesimi i kapitalit
 - ndryshimi i shoqerise ne shoqeri anonime

Neni 21

- a) Asambleja eshte e zakoneshme dhe e jashtezakoneshme sipas ligjit.
- b) Asambleja mund te thirret edhe jashte qendres se shoqerise.
- c) Thirrja e asamblese behet nga administratori dhe mund te kerkohet edhe nga nje ose me shume ortak qe perfaqesojne me shume se 10 perqind te kapitalit shoqeror.
- d) Thirrja e asamblese behet me ane rre letres rekomande ose me çdo mjet tjeter, ne menyre qe ortaket te njoftohet per kete, te pakten, 15 dite para dates se mbledhjes.
- e) Megjithate, mbledhja konsiderohet e vlefshme, edhe ne rast se nuk eshte zbatuar procedura e mesiperme, kur te gjithë ortaket jane prezent ose te perfaqesuar.
- f) Nje ortak mund te perfaqesohet nga nje ortak tjeter, por ai nuk mund t'i delegoje perfaqesuesit te drejten te votoje per nje pjese te kuotes perkatese.

Neni 22

Administrimi i shoqerise behet nga te dy ortaket, te cilet jane edhe administratore te shoqerise. Ata perfaqesojne shoqerine para organeve shteterore dhe privateve, vendas dhe/apo te huaj.

Neni 23

Administratoret kane kompetence te veprojne ne emr dhe per llogari te shoqerise kundrejt te treteve, me perjashtim te kompetencave qe ka asambleja e ortakeve. Secili prej tyre ka te drejte te veproje i vetem dhe te marre paraprakisht ose te informoje ortakun tjeter per veprimet e kryera.

Miratimi i mevonshem ka fuqi prapavepruese.

Neni 24

Nder detyrat e administratorit jane edhe keto:

- a- te kryeje ne emer dhe per llogari te shoqerise veprime si lidhja e kontratave dhe marreveshjeve, perfaqesimi i shoqerise ne organet dhe entet shtetere, administrative, ekonomike, gjyqesore, financiare, fiskale, doganore, kundrejt ersonave juridike dhe shtetasve. Keto veprime mund t'i kryeje vete ose me perfaqesues te ngarkuar me prokure te posaçme.
- b) te kujdeset per hartimin dhe mbajtjen e librave te shoqerise, ku te regjistohen pasurite e shoqerise dhe aktiviteti i saj si dhe bilancit te shoqerise me llogarine fitime e humbje.
- c- eshte i detyruar te njoftoje asamblene e ortakeve per aktivitetin e tij

Neni 25

- a) Asambleja e Ortakeve ka te drejte te ndryshoje dhe te anulloje veprimet e administratorit, te cilat nuk perputhen me ligjin dhe me kete statut, duke vendosur edhe per pasojat ndaj te treteve ne menyre qe ato te jene minimale.
- b) Shoqeria nuk pergjigjet per pasojat ndaj te treteve ne rast se provohet qe ata ishin ne dijeni te faktit qe akti i administratorit nuk ka qene ne perputhje me ligjin ose me statutin.
- c) Ne kontratat e pergjitheshme ose ne ato me karakter te veçante, eshte e nevojeshme te merret edhe miratimi i asamblese. Ky miratim mund te merret edhe me vone dhe ka fuqi prapavepruese.

Neni 26

- a) Espertet emerohen duke i zgjedhur ndermjet personave te besuar dhe me aftesi profesionale edhe jashte bashkesise se ortakeve, me perjashtim te atyre qe ndalohen me ligj.
- b) Ekspertet kane per detyre te kontrollojne zbatimin e normave ligjore, te statutit, mbajtjen e rregullt te dokumentacionit dhe regjistrave dhe kryerjen e sakte te operacioneve te ndryshme dhe per keto i raportojne asamblese se ortakeve.

Neni 27

- a) Asambleja e ortakeve percakton shperblimet qe u takojne eksperteve dhe administratoreve.

- b) Shperblimet per personelin vartes percaktohen nga kontratat e punes te lidhura ndermjet administratorit dhe punonjesit.

KREU VII

AKTIVITETI EKONOMIK DHE FINANCIAR

Neni 28

Qellimi i shoqerise eshte mbulimi i shpenzimeve dhe realizimi i fitimeve.

Neni 29

Per te realizuar qellimin e saj, shoqeria mund te kryeje edhe keto veprime:


- a) te hape depozita dhe llogari prane bankave dhe institucioneve te tjera te kreditit.
- b) te marre hua nga bankat dhe nga persona te veçante.
- c) te lidhe kontrata e akte te tjera sipas ligjit dhe interesave te saj.
- d) te hape filiale, seksione, agjensi dhe zyra perfaqesimi ne rrethe te tjera te vendit.
- e) te kete pasuri te palujteshme, te cilat regjistrohen prane zyrave kompetente sipas ligjit.
- f) te marre pjese ne shoqeri te tjera.

Neni 30

- a) Viti financiar çelet me 1 janar dhe mbyllet me 31 dhjetor te çdo viti.
- b) Brenda kater muajve nga mbyllja e tij, duhet te jete hartuar bilanci i aktivitetit te shoqerise.
- c) Asambleja e ortakeve per miratimin e bilancit mblidhet brenda kater muajve nga mbyllja e vitit financiar dhe, per motive shume te veçanta, brenda gjashte muajve.

Neni 31

- a) Te ardhurat e realizuara i nenshkrohen te gjitha tatimeve dhe taksave te percaktuara nga ligji.
- b) Fitimi i nenshtrohet nje zbritje prej jo me pak se pese perqind per fond rezerve. Kjo klauzole nuk eshte më e detyrueshme ne rast se perqindja e rezerves arrin ne 10 perqind te kapitalit themeltar.



Neni 32

- a) Kontabiliteti mbahet sipas ligjeve shqiptare.
- b) Humbjet qe rezultojne mbulohen nga fondi rezerve dhe ne rast se ato nuk mjaftojne, nga po keto fonde te destinuar per vitin e ardhshem.
- c) Asambleja e ortakeve mund te vendose per forma te tjera te mbulimit te humbjeve.
- d) kur nga humbjet e rezultuara, kapitali shoqeror mbetet me pak se kufiri minimal i percaktuar nga ligji, brenda tre muajve, asambleja e ortakeve vendos per mbulimin e tyre dhe per vazhdimesine e shoqerise. Ne rast te kundert, çdo person i interesuar, mund t'i drejtohet gjykates duke kerkuar likuidimin e shoqerise.

KREU VIII

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Neni 33

- a) Ne rast te mosmarreveshjeve te ortakeve ndermjet tyre dhe/ose trashegimtareve te tyre, asambleja e ortakeve do te perpiket t'i zgjidhe ato me mirekuptim.
- b) Ne rast se nuk arrihet ne nje marreveshje, do te zgjidhen ne rruge arbitrazhi, sipas neneve 400 e vijues te Kodit te Procedures Civile ose ne rruge gjyqesore, duke zbatuar normat proceduriale.

Neni 34

Mosmarreveshjet ndermjet shoqerise dhe personave te trete ose ndermjet shoqerise dhe te punesuarve te saj, ne rast se nuk zgjidhen me mirekuptim do te trajtohen ne rruge gjyqesore sipas ligjit.

KREU IX

PUSHIMI DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Neni 35

- a) Shoqeria pushon aktivitetin e saj:
 - 1. kur mbaron afati i percaktuar ne statut.
 - 2. me vendim unanimit te asamblese.
 - 3. per shkak te nderprerjes se aktivitetit.
 - 4. me falimentim.
 - 5. me vendim gjyqesor ne rastet e percaktuara nga ligji.
 - 6. ne raste te tjera te percaktuara nga ligji.

- b) Ne keto raste asambleja e ortakeve emeron nje ose me shume likuidatore. Ne rast te kundert, eshte gjykata qe emeron likuidatoret dhe percakton perfundimin e likuidimit.
- c) Ne perfundim te likuidimit, mbetja qe rezulton i ndahet ortakeve proporcionalisht me kuotat e tyre aktuale ne shoqeri.

Neni 36

Shoqeria nuk pushon aktivitetin e saj, ne rast se ndonjeri nga ortakët vdes, falimenton, ose behet i paafte per shkak semundje.

KREU X

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 37

Problemet e punesimit ne shoqeri percaktohen dhe rregullohen sipas legjislacionit te punes, duke lidhur kontratat perkatese.

Neni 38

Ku statut eshte hartuar ne baze te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare".

Neni 39

Ne rast te ndryshimeve ne legjislacion, qe per pasoje do te sjellin mosperputhje te statutit, ky i fundit do te modifikohet ne menyre qe te jete ne perputhje me ndryshimet e bera ne legjislacion.

ORTAKET PJESEMARRES

ZIJA BROLI

JULIAN BROLI

REPUBLICA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTEREVE DURRES

NR.REP. 32 NR.KOL. 12

V E R T E T I M

Ne Durres, sot me daten 17.01.2000 (shtatembedhjete janar dymije) para meje noteres SHPRESA SKRAME, anetare e Dhomes se Notereve Durres, u paraqiten personalisht: ----


ZIJA BROLI, i biri i Halit, lindur me 10.04.1950, ne Durres banues ne Durres, me zotesi te plote per te vepruar, identiteti sipas

leternjoftimit QH NR.477391.---

JULIAN BROLI, i biri i Zijait, lindur me 28.10.1979, lindur ne Durres dhe banues ne Durres, me zotesi te plote per te vepruar, identiteti sipas pasaportes 1437848 leshuar ne Durres me 19.08.99.---
te cilet para meje nenshkruan kete statut. Une noterja, bazuar ne ligjin nr.7829 date 1.06.94 vertetohet.-----

N O T E R E

SHPRESA SKRAME

A handwritten signature in black ink is written over a circular official stamp. The stamp contains some illegible text and a date, possibly '1999'.



K E R K E S E

e

KERKUESVE : ZIJA BROLI, i biri i Halitit, dtl.1950, lindur dhe banues ne Durres

JULIAN BROLI, i biri i Zijait, dtl.1979, banues ne Durres

ME OBJEKT : Kerkojme regjistrimin si person juridik te shoqerise ILIR shpk, ne baze te ligjit nr.7667 date 28.01.1993.

GJYKATES SE RRETHIT

22630

TIRANE

Z.Kryetar.

Be regjistruar me numer akt 17-01-2000 gjykatore M. Dera? [Signature]

Ju parashtrojme se jemi ortakët themelues te shoqerise ILIR hpk me qender ne Durres, lagje nr.13, RR.B.Curri, me ortakë themelues dhe administratore te dy kerkuesit, me kpohezgjatje mni 10 vjet, me objekt te aktivitetit te saj : Tregetim me shumice dhe pakite te mallrave te ndryshem te te gjitha llojeve, tregetim te materialeve inetre, iport eksport.

Meqenese jane plotesuar te gjitha kushtet qe kerkon ligji, kerkojme regjistrimin si person juridik ne Regjistrin tregetar.

Bashkelidhur, statutin, aktin e themelimit, konfermen bankare.

K E R K U E S I T

ZIJA BROLI
Zija Broli
[Signature]

JULIAN BROLI
Julian Broli
[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE DURRES
NR.REP. 32 NR.KOL. 12

V E R T E T I M

Sot, me daten 17.01.2000 shtatembdhjete janar dymije, ne dhomen e notereve Durres, u paraqiten personat e mesiperme te cilet i verifikova sipas ligjit te cilet para mzeje nenshkruan kete kerkese; Une noterja ,bazuar ne ligjin nr.7829 date 1.6.94 vertetoj.

